



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

**DREJTORIA E FINANCËS, PROKURIMEVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI FINANCËS DHE BUXHETIT**

Nr. 464 Prot.

Tiranë, më 27.02.2026

Lënda: Dërgohet raporti i monitorimit të ecurisë së zbatimit të buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2025.

**MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë**

Mbështetur në ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, ju dërgojmë bashkëngjitur raportin e monitorimit të ecurisë së zbatimit të buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2025.

Bashkëngjitur relacioni i raportit të monitorimit me anekset përkatëse.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Alban Çela**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR NË DREJTORINË E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**

Denis Kristo



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300
www.instat.gov.al

**DREJTORIA E FINANCËS, PROKURIMEVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI FINANCËS DHE BUXHETIT**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____. 2026

Lënda: Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të Institutit të Statistikave, për periudhën Janar - Dhjetor 2025.

**MINISTRISË SË FINANCEVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë**

Instituti i Statistikave, mbështetur në ligjin me nr. 17, datë 05.04.2018 “Për Statistikat Zyrtare”, është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Misioni i tij është të prodhojë statistika asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit dhe transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Programi i Statistikave Zyrtare, 2022-2026, përcakton strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor, duke synuar përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për statistika cilësore. Programi përmban aktivitetet statistikore, të cilat janë në funksion të zbatimit të strategjisë dhe prioritetëve të institucionit. Politika e këtij programi konsiston në prodhimin e të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke u përqëndruar në fenomene thelbësore për vendimmarrësit, si dhe duke respektuar të drejtën e qytetarëve për të dhëna zyrtare, në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Institucionit, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në implementimin e objektivave që bëjnë të mundur përmbushjen e standardeve të vendosura nga BE, në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të përdorimit të burimeve njerëzore dhe financiare të INSTAT-it.

Buxheti i Institutit të Statistikave për vitin 2025, i miratuar me ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, është **996,328,000 (nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtëmilion e treqind e njëzet e tetë mijë) lekë.**

Këto fonde, Instituti i Statistikave i administron në një program buxhetor “Veprimtaria Statistikore”, si më poshtë vijon:

- Fondi i Pagave: 606,495,000 lekë.
- Fondi i Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore: 97,803,000 lekë.
- Mallra dhe shërbime të tjera: 148,210,000 lekë.
- Transferta korente të brendshme: 1,570,000 lekë.
- Transferta për buxhete familjare dhe individë: 1,150,000 lekë.
- Fondi për investime të brendshme të trupëzuara: 41,100,000 lekë.

- Fondi për investime të huaja: 100,000,000 lekë.

Numri i punonjësve për vitin 2025 në strukturë, i miratuar me ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar është, plani: 260 dhe fakti: 225.

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtaria statistikore”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit, të hartuar gjatë procesit të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe është në funksion të realizimit të Politikës së Programit.

Monitorimi i buxhetit të INSTAT, për periudhën Janar-Dhjetor 2025, përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e INSTAT-it kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit të INSTAT-it të përfshirë në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026.

Për Insitutin e Statistikeve, për vitin 2025, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë kësaj periudhe, paraqitet sipas tabelës më poshtë:

në lekë

Programet	Buxheti fillestar 2025	Buxheti me ndryshime 2025	Diferenca
	(1)	(2)	(3=2-1)
Veprimtaria statistikore	1,022,100,000	996,328,000	-25,772,000

Ndryshimi i planit gjatë vitit 2025, paraqitet me diferenca për shkak të akordimit të fondeve për përdorimin e fondit të veçantë të Ministrisë së Financave sipas shkresës me nr. 2244/1 prot., datë 06.02.2025 ku u shtuan 650,000 lekë dhe shtesë fondi në vlerën 29,000,000 lekë në zërin Investime të brëndshme, sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 9326/53 prot. datë 08.07.2025 të Ministrisë së Financave, “Në zbatim të Aktit Normativ Nr. 6, datë 11.06.2025” drejtuar Insitutit të Statistikave.

Gjithashtu ndryshime në buxhet paraqitet me diferenca, ku sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 18,059 prot. datë 22.12.2025, “Mbi detajimin e ndryshimeve të buxhetit sipas Aktit Normativ Nr. 11, datë 22.12.2025”, drejtuar Insitutit të Statistikave u pakësuan 55,422,000 lekë.

Politika e këtij institucioni është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e me cilësi e të dhënave statistikore në fushat ekonomike, sociale, të zhvillimit demografik dhe mjedisor në nivel qendror dhe lokal.
- Përdorimi i burimeve të të dhënave dhe instrumenteve të duhura, për të përmirësuar prodhimin dhe cilësinë e treguesve dhe shërbimeve statistikore.
- Përmirësimi profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor.
- Zhvillimi i sistemeve inovative I.T.C. për përpunimin statistikor, shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Villazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al

Menaxhimi i buxhetit është fokusuar në financimin e shpenzimeve në funksion të përmbushjes së objektivave prioritare strategjike të mëposhtme:

- Përmirësimin e cilësisë së realizimit të vrojtimeve, duke përdorur teknika moderne për grumbullimin e përpunimin e të dhënave, si dhe duke rritur kapacitetin profesional të punonjësve mbështetës nëpërmjet trajnimeve.
- Zgjerimin e fushës së mbulimit me aktivitete të reja sipas kërkesave të përdoruesve dhe të rrisë numrin e njësive statistikore (njësi ekonomike dhe familje) të intervistuar në vrojtimet statistikore.
- Paraqitjen e një produkti statistikor të përmirësuar cilësor dhe sasior tek përdoruesit, nëpërmjet publikimeve statistikore, zhvillimit të konferencave, interpretimit të tyre me mjete të ndryshme komunikimi.
- Mirëmenaxhimin e institucionit, duke aplikuar një menaxhim të lartë administrativ të burimeve financiare dhe njerëzore.
- Përditësimin e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e proceseve të përpunimit të të dhënave.
- Pajisjen e punonjësve me bazën e nevojshme materiale dhe kompjuterike për përpunimin e të dhënave, si dhe të krijohen kushte të përshtatshme pune për punonjësit nëpërmjet mobilimit të zyrave.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të ligjit me nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, për periudhën e raportuar, Instituti i Statistikave ka realizuar vlerën buxhetore në shumën prej **986,986,210 lekë ose 99.1 % të fondit të planifikuar për vitin 2025.**

➤ Performanca e shpenzimeve gjatë vitit 2025.

Në fund të vitit 2025, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin e periudhës paraqitet si më poshtë:

në lekë

Llog. Ekonomike	Përshkrimi	Plan buxheti vjetor 2025	Plan buxheti vjetor i ndryshuar 2025	Buxheti i realizuar viti 2025	Realizimi në % viti 2025
600	Paga	651,790,000	606,495,000	597,836,120	98.6
601	Kontribute Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	112,110,000	97,803,000	97,367,590	99.6
602	Mallra dhe shërbime të tjera	141,030,000	148,210,000	146,443,743	98.8
604	Transferime korente	1,570,000	1,570,000	559,000	35.6
606	Transferime buxhetesh familjare	0	1,150,000	1,147,516	99.8
231	Kapitale të trupëzuara	15,600,000	41,100,000	33,023,688	80.3
231	Financim i huaj	100,000,000	100,000,000	104,207,530	104.2
	Të ardhura jashtë limitit	0	0	6,401,023	0.0
	TOTALI	1,022,100,000	996,328,000	986,986,210	99.1

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Villazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al

➤ **“Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore” (artikulli 600-601)**

Struktura e Insitutit të Statistikave është miratuar me Vendim të Kuvendit me nr. 28/2025, datë 17.03.2025 “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 127/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Insitutit të Statistikave”, në total është 260 punonjës. Për vitin 2025, fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, është realizuar në zbatim të numrit të punonjësve, miratuar me ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, në total 260 punonjës dhe punonjësit me kontratë të përkohshme pune në total 1,617 punonjës.

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit, i ndryshuar për vitin 2025, për zërin “Paga” (artikulli 600) është 606,495,000 lekë, nga të cilat janë shpenzuar 597,836,120 lekë, ose 98.6 % e planit vjetor 2025.

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit, i ndryshuar për vitin 2025, për zërin “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” (artikulli 601), është 97,803,000 lekë, nga të cilat janë shpenzuar 97,367,590 lekë, ose 99.6 % e planit vjetor 2025.

Në zërin “Paga, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” përfshihen pagat e punonjësve të strukturës të Insitutit të Statistikave, si dhe pagat e punonjësve me kontratë të përkohshme pune, për organizimin dhe zhvillimin e anketave, mbështetur në përlllogaritjen e numrit të punonjësve të domosdoshëm sipas pozicioneve, duke mbajtur parasysh kontributin e çdo pozicioni në secilën anketë.

Për periudhën vitin 2025 për zërin “Paga, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore”, ka patur ndryshime ku sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 18,059 prot. datë 22.12.2025 të Ministrisë së Financave, “Mbi detajimin e ndryshimeve të buxhetit sipas Aktit Normativ Nr. 11, datë 22.12.2025” drejtuar Insitutit të Statistikave u pakësuan 50,522,000 lekë.

➤ **“Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”. (artikulli 602)**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit, i ndryshuar, për vitin 2025 për zërin “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera” është 148,210,000 lekë dhe janë shpenzuar 146,443,743 lekë ose 98.8 % e planit vjetor.

Në zërin “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” përfshihen pagat e anketuesve me kontratë shërbimi, shpenzime ndaj të tretëve, si dhe shpenzime për blerje dhe shërbime të ndryshme për institucionin.

Ndryshime në buxhet për zërin shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera janë kryer sipas shkresës me nr. 269 prot. datë 30.01.2025 të Insitutit të Statistikave “Mbi transferimin e fondeve buxhetore” drejtuar Ministrisë së Financave, ku u pakësuan 500,000 lekë nga artikulli 602 dhe u shtuan në artikullin 606 për kompesim të telefonisë celulare.

Për vitin 2025 për zërin “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”, ka patur ndryshime ku sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 18,059 prot. datë 22.12.2025 të Ministrisë së Financave, “Mbi detajimin e ndryshimeve të buxhetit sipas Aktit Normativ Nr. 11, datë 22.12.2025” drejtuar Insitutit të Statistikave u pakësuan 1,400,000 lekë.

Për vitin 2025 realizimi në grupin e shpenzimeve operative është mbështetur duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

1. *"Shërbimi i ruajtjes me roje civile"* sipas kontratës me nr. 2067/2 prot., datë 30.12.2024, nënshkruar midis Institutit të Statistikave dhe Operatorin Ekonomik me kapital shtetëror "Illyrian Guard" sh.a, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.177, datë 04.04.2019 *"Për krijimin e Shoqërisë "Illyrian Guard" Sh.A. dhe për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie"*.
Për fondin e parashikuar për grup artikullin *"Shërbimi i ruajtjes me roje civile"*, për godinën e Insitutit të Statistikave, për vitin 2025, vazhdoi kontrata e shërbimit me nr. 2067/2 prot., datë 30.12.2024, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj, nga momenti i nënshkrimit të kontratës.
2. *"Shërbimi i marrjes me qera të ambientit të magazinimit të tabletave të blera në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023"*, sipas kontratës me nr. 861/4 prot., datë 02.09.2024, me nr. repertori 2424 nr. koleksioni 1561 datë 02.09.2024 *"Amendim Kontratë Qeraje"* nënshkruar midis Institutit të Statistikave dhe operatorin ekonomik Natural Health Sh.pk.
Për fondin e parashikuar për grup artikullin *"Shërbimi i marrjes me qera të ambientit të magazinimit të tabletave"*, për vitin 2025, është shpenzuar në total 1,260,000 lekë. Kontrata e nënshkruar midis Institutit të Statistikave dhe operatorin ekonomik "Natural Health" Sh.P.K. ka përfunduar.
3. Për fondin e parashikuar për *"Blerje materiale Higjeno Sanitare"* me fond limit 360,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Bledi Loçi" me vlerë ekonomike të ofertuar 179,826 dhe operatori ekonomik "Natasha Vaska" me vlerë ekonomike të ofertuar 70,560 lekë dhe operatori ekonomik "Solid Grup" me vlerë ekonomike të ofertuar 71,040 lekë ose 89.2 % e fondit të planifikuar.
4. *"Blerje karburant naftë"* me fond limit 3,000,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur e thjeshtuar, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Gega Center GKG" Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 2,684,358 me tvsh lekë ose 89.4 % e fondit të planifikuar.
5. Për fondin e parashikuar për *"Blerje siguracion godine dhe paisjeve të zyrës"* me fond limit 420,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "INSIG" SH.A, me vlerë ekonomike të ofertuar 415,200 lekë ose 98.8 % e fondit të planifikuar.
6. *"Blerje Bileta Avioni"*, me fond limit 2,500,000 lekë me tvsh, janë realizuar, sipas rastit, procedurat e blerjes nëpërmjet sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe është shpenzuar në total në vlerën 1,910,140 lekë me tvsh, ose 76.4 % e fondit të planifikuar.
Për shpenzimet e kryera për blerje bileta avioni janë zhvilluar takime pune, konferenca, trajnime etj. për punonjësit e Insitutit të Statistikave, sipas kërkesave të miratuara nga Titullari, në vijim

të të cilave janë realizuar procedurat përkatëse të prokurimit, me Operatorët Ekonomikë fitues, të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Objekti i Prokurimit	Fondi i parashikuar me TVSH	Vlera e kontratës me TVSH	Fituesi
Blerje bileta avioni	2,500,000	14,000	Amadeos Travel & Tours
		78,490	Amadeos Travel & Tours
		58,000	Amadeos Travel & Tours
		334,000	Amadeos Travel & Tours
		82,000	Kelvin Travel
		158,500	Pelingu Sh.P.K
		50,500	Amadeos Travel & Tours
		29,500	Spirit Travel & Tours
		35,770	2 Feleqi
		109,600	Amadeos Travel & Tours
		22,770	2 Feleqi
		269,000	Amadeos Travel & Tours
		83,000	Amadeos Travel & Tours
		79,900	2 Feleqi
		55,770	Amadeos Travel & Tours
		37,240	Amadeos Travel & Tours
		38,300	Kelvin Travel
		77,000	Spirit Travel & Tours
		40,760	Amadeos Travel & Tours
		33,220	2 Feleqi
		23,000	Amadeos Travel & Tours
		13,300	Spirit Travel & Tours
		21,070	Amadeos Travel & Tours
41,650	Amadeos Travel & Tours		
28,000	Amadeos Travel & Tours		
69,000	Amadeos Travel & Tours		
26,800	Amadeos Travel & Tours		
Totali	2,500,000	1,910,140	

7. Për fondin e parashikuar për "*Blerje siguracion për automjetet e INSTAT*", me fond limit 200,000 është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "INSIG" Sh.A., me vlerë ekonomike të ofertuar 199,763 lekë me tvsh ose 99.8 % e fondit të planifikuar.
8. "*Blerje materiale kancelari dhe letër*" me fond limit 2,001,206 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur e thjeshtuar, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "IT Gjergji kompjuter" Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 1,319,964 lekë me tvsh ose 65.9 % e fondit të planifikuar.
9. "*Shërbim mirëmbajtje printera*" me fond limit 1,680,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur e thjeshtuar, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "BT

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Villazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al

- Solutions", me vlerë ekonomike të ofertuar 1,629,600 lekë me tvsh ose 97 % e fondit të planifikuar.
10. Për fondin e parashikuar për "*Blerje uje për pritje përcjellje*" me fond limit 120,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit në vlerë jo më shumë se 100 mijë lekë pa tvsh, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "New Century" Sh.P.K me vlerë ekonomike të ofertuar 94,500 lekë ose 78.7 % e fondit të planifikuar.
 11. "*Rinovim i licencave egzistuese SAS*," me fond limit 4,800,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Infosoft System", me vlerë ekonomike të ofertuar 4,733,854 lekë me tvsh ose 98.6 % e fondit të planifikuar.
 12. "*Rinovim i licencave egzistuese Fortinet*" me fond limit 600,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "PC Store", me vlerë ekonomike të ofertuar 450,000 lekë me tvsh ose 75 % e fondit të planifikuar.
 13. "*Rinovim i licencave egzistuese ESRI*" me fond limit 5,400,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "GDI" Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 5,280,000 lekë me tvsh ose 97.7 % e fondit të planifikuar.
 14. "*Rinovim i licencave egzistuese VEEAM*" me fond limit 1,600,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "PC Store" Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 1,530,000 lekë me tvsh ose 95.6 % e fondit të planifikuar.
 15. "*Rinovim i licencave për sistemin SIEM*" me fond limit 11,300,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Sinteza CO" Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 11,256,000 lekë me tvsh ose 99.6 % e fondit të planifikuar.
 16. "*Shërbim riparim/mirëmbajtje Bateri qendrore*" me fond limit 1,200,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur e thjeshtuar, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Sinteza CO" Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 1,167,600 lekë me tvsh ose 97.3 % e fondit të planifikuar.
 17. "*Shërbim mirëmbajtje kondicionerësh të dhomës së serverave dhe baterisë*" me fond limit 320,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Express Air Conditioning", me vlerë ekonomike të ofertuar 300,000 lekë me tvsh ose 93.7 % e fondit të planifikuar
 18. Për fondin e parashikuar për "*Shërbim profilaktik dhe riparim automjetesh*", me fond limit 215,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Big Boys Auto Garage", me vlerë ekonomike të ofertuar 214,400 lekë me tvsh ose 99.7 % e fondit të planifikuar.
 19. Për fondin e parashikuar për "*Shërbim për sistemin SIMONA*", me fond limit 600,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Infosoft Systems" Sh.p.k, me vlerë ekonomike të ofertuar 568,800 lekë me tvsh ose 94.8 % e fondit të planifikuar.
 20. Për fondin e parashikuar për "*Botim Shtypshkrime për INSTAT*", me fond limit 3,500,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit e hapur e thjeshtuar, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Infosoft System" Sh.p.k, me vlerë ekonomike të ofertuar 3,116,400 lekë me tvsh ose 89 % e fondit të planifikuar.

➤ **“Transferta korrente të brëndshme”. (artikulli 604)**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit, për vitin 2025, për zërin “*Transferta korrente të brëndshme*” është 1,570,000 lekë, nga të cilat janë shpenzuar 559,000 lekë, ose 35.6 % planit vjetor. Shpenzimet e kryera janë për mbledhje të zhvilluara nga Këshilli i Statistikës dhe mbledhje të zhvilluara nga Komisioni i Nomeklaturës.

➤ **“Transferta për buxhete familjare”. (artikulli 606)**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2025 për zërin “*Transferta për buxhete familjare*” është 1,150,000 lekë, nga të cilat janë shpenzuar 1,147,516 lekë, ose 99.8 % planit vjetor.

Fondet e shpenzuara për zërin “*Transferta për buxhete familjare*” janë kryer konkretisht për katër raste dalje në pension, dhjetë raste shpërblim për fatkeqësi dhe kompesime të telefonisë celulare.

Fondet e akorduara për zërin Fondi i Veçantë janë kryer në bazë të shkresës me nr. 2244/1 prot. datë 06.02.2025 të Ministrisë së Financave “*Mbi miratimin i detajimit të planit për fondin e vecantë 2025*”, drejtuar Insitutit të Statistikave, ku u shtuan 650,000 lekë dhe shkresës me nr. 269 prot. datë 30.01.2025 të Insitutit të Statistikave “*Mbi transferimin e fondeve buxhetore*” drejtuar Ministrisë së Financave ku u shtuan 500,000 lekë me transferim fondi nga llogaria 602 te llogaria 606 për kompesim të telefonisë celulare.

➤ **“Shpenzime për Investime”. (artikulli 230-231)**

Bazuar në ligjin me nr. 115/2024, “*Për buxhetin e vitit 2025*”, plani i buxhetit për “*Shpenzime për Investime*” nga buxheti i shtetit i ndryshuar është në shumën 41,100,000 lekë.

Ndryshime në buxhet për zërin shpenzime për investime janë kryer sipas shkresës me nr. 9326/53 prot. datë 08.07.2025 të Ministrisë së Financave “*Në zbatim të Aktit Normativ Nr. 6, datë 11.06.2025*” drejtuar Insitutit të Statistikave, ku u shtuan 29,000,000 lekë për likuidimin e detyrimeve të kontratës me nr. 1430/30 prot. datë 20.12.2024 “*Blerje paisje kompjuterike servera dhe storage*”, lidhur midis Insitutit të Statistikave dhe Communication Progress Sh.P.K.

Gjithashtu ndryshime në buxhet për zërin shpenzime për investime janë kryer sipas shkresës nr. 18,059 prot. datë 22.12.2025 të Ministrisë së Financave, “*Mbi detajimin e ndryshimeve të buxhetit sipas Aktit Normativ Nr. 11, datë 22.12.2025*” drejtuar Insitutit të Statistikave ku u pakësuan 3,500,000 lekë.

Planifikimi në buxhet për vitin 2025 për shpenzime për investime është bërë për blerje paisje kompjuterike liçenca, servera dhe storage si dhe për likuidim të TVSH-së, në bazë të marrëveshjeve që janë me donatorët.

1. Për fondin e parashikuar për “*Blerje sistem Audio-Vidio Conferencë*” me fond 120,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik “PC Store” Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 117,480 lekë me tvsh lekë ose 97.9 % e fondit të planifikuar.
2. “*Blerje paisje kompjuterike servera dhe storage*” me vlerë kontrate 29,352,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur, ku ka rezultuar fitues operatori

ekonomik "Communication Progress" Sh.P.K, dhe është likujduar në vlerën 23,016,000 lekë me tvsh ose 78.4 % e vlerës së kontratës.

3. Për fondin e parashikuar për "*Blerje Licenca Softwarë për monitorimin e faqes së Web*" me fond limit 1,425,200 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur e thjeshtuar, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Communication Progress" Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 1,176,000 lekë me tvsh ose 82.5 % e fondit të planifikuar.
4. "*Blerje Licenca Adobe Creative Cloud*" me fond limit 180,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur e thjeshtuar, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Infosoft Systems" Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 141,638 lekë me tvsh ose 78.6 % e fondit të planifikuar.
5. "*Blerje Licenca SPPS*" me fond limit 2,880,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur e thjeshtuar, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Infosoft Systems" Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 2,804,880 lekë me tvsh ose 97.3 % e fondit të planifikuar.
6. "*Blerje Licenca MDM*" me fond limit 720,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur e thjeshtuar, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Infosoft Systems" Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 706,560 lekë me tvsh ose 98.1 % e fondit të planifikuar.
7. "*Blere licenca Verisign SSL Certificate WildCard*" me fond limit 360,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit e hapur e thjeshtuar, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Infosoft System" Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 342,719 lekë me tvsh ose 95.1 % e fondit të planifikuar.
8. *Blerje Karrige*, " me fond limit 700,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "*Muca*" Sh.P.K, me vlerë ekonomike të ofertuar 581,200 lekë me tvsh ose 83 % e fondit të planifikuar.
9. "*Likujdim T.V.Sh*", plani për vitin 2025 është 8,470,000 dhe është realizuar në shumën 4,050,211 lekë ose 47.8 %. Likujdimi i TVSh- së është kryer sipas faturave që Insituti i Statistikavë ka bërë pagesat me llogaritë e projekteve me bankat e nivelit të dytë të donatorëve.

Realizimi i shpenzimeve me "Financim të Huaj" për vitin 2025 është 104,207,530 lekë.

Projektet që menaxhohen nga Instituti i Statistikave janë si më poshtë vijon:

1. Salstat - Statistika të Forta Vendore.
2. Mbështetje për CENS.
3. IPA 2019 Multi-Beneficiary Statistical Cooperation Programme.

Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit për vitin 2025 janë në vlerën 6,401,023 lekë.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al

Realizimi në sasi sipas “*Treguesve të performancës/produktit*” për vitin 2025 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i Treguesit të Performancë/ Produktit	Plani viti 2025	Fakti viti 2025	% Realizimit
1	Njësi statistikore të vrojtuar	335,571	298,830	89.0%
2	Të dhëna të publikuara	181	177	97.7%
3	Personel i trajnuar	260	225	86.5%
4	Auditime të kryera	7	7	100.0%
5	Blerje Liçensa	207	207	100.0%
6	Blerje Karrige zyre	75	75	100.0%

Treguesi i performancë/produktit “*Njësi statistikore të vrojtuar*” është realizuar 89.0%.

Treguesi i performancë/produktit “*Të dhëna të publikuara*” është realizuar 97.7%.

Treguesi i performancë/produktit “*Personel i trajnuar*” është realizuar 86.5 %.

Treguesi i performancë/produktit “*Auditime të kryera*” është realizuar 100.0%.

Treguesi i performancë/produktit “*Blerje liçensa*” është realizuar 100.0%.

Treguesi i performancë/produktit “*Blerje karrige zyre*” është realizuar 100.0%.

Menaxhimi efektiv i fondeve buxhetore të akorduara për Insitutin e Statistikave, në funksion të një vendimmarrje transparente do të vazhdojë të jetë një faktor i rëndësishëm në realizimin e punës, në drejtim të shpenzimeve të miratuara vjetore për përmbushjen e qëllimit dhe objektivave institucionale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Alban Çela

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR NË DREJTORINË E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**

Denis Kristo



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Villazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al

ANEKSI nr.1 Raporti Përmblledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor

Periudha e Raportimit Janar-Dhjetor 2025

në/lekë


Emri i Grupit		Kodi i grupit									
		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit									
Kodi i Programit	Emërtimi	Viti paraardhës 2024		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progressive		
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7 (5-3))	(8)	(9)	(10 (5-8))	(11 (8/5))	
Shpenzimet sipas programeve buxhetore											
01320	Emërtimi										
	Vepirmania Statistikore	962,727,077	100.0	1,022,100,000	100.0	100.0	980,585,187	100.0	15,742,813	98.4	
	Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kap 01.02.03.04.05.08.22)	962,727,077	100.0	1,022,100,000	100.0	100.0	980,585,187	100	15,742,813	98.4	
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	9,011,791					6,401,023		-6,401,023		
	Totali Shpenzimeve të Ministrisë	971,738,868	100.0	1,022,100,000	100.0	100.0	986,986,210	100	9,341,790	99.1	
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik											
Emërtimi											
600	Paga	561,965,338	58.4	651,790,000	63.8	60.9	597,836,120	61.0	8,658,880	98.6	
601	Sigurime Shoqërore	92,918,767	9.7	112,110,000	11.0	9.8	97,367,590	9.9	435,410	99.6	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	97,873,830	10.2	141,030,000	13.8	14.9	146,443,743	14.9	1,766,257	98.8	
603	Subvencione	0	0.0	0	0.0	0.0	0	0.0	0	0	
604	Transfera Korente të Brendshme	751,400	7.8	1,570,000	15.4	15.8	559,000	5.7	1,011,000	35.6	
605	Transfera Korente të Huaja	0	0.0	0	0.0	0.0	0	0.0	0	0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	5,695,882	0.6	0	0.0	0.1	1,147,516	0.1	2,484	99.8	
	Non-Totali Shpenzime Korrente	759,205,218	78.9	906,500,000	88.7	85.8	843,353,969	92	11,874,031	98.6	
230	Kapitale të Patrupezuara	3,067,000	0.3	0	0.0	0.0	0	0.0	0	0	
231	Kapitale të Trupezuara	12,138,439	1.3	15,600,000	1.5	4.1	33,023,688	3.4	8,076,312	80.3	
	Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	15,205,439	1.6	15,600,000	1.5	4.1	33,023,688	3	8,076,312	80.3	
230	Kapitale të Patrupezuara	176,344,140	18.3	100,000,000	0.0	0.0	104,207,530	10.6	-104,207,530		
231	Kapitale të Trupezuara	11,972,280	0.0	100,000,000	0.1	0.1	0	0.0	100,000,000		
	Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	188,316,420	19.6	100,000,000	9.8	10.0	104,207,530	11	-4,207,530	104.2	
	Totali Shpenzime Kapitale	203,521,859	21.1	115,600,000	11.3	14.2	137,231,218	14	3,868,782	97.3	
	Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor	962,727,077	100.0	1,022,100,000	100.0	100.0	986,986,210	106	15,742,813	98.4	
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	9,011,791					6,401,023				
	Totali (Korrente + Kapitale + Shpenzanga te ardh.jashte limiti	971,738,868	100.0	1,022,100,000	100.0	100.0	986,986,210	106	15,742,813	99.1	
	Numri i punonjësve	0		236		260					

Emri _____

Firma _____

Data _____

27.02.2025




Sekretari i Përgjithshëm

